

Identifikimi i automjetit

Modeli

Nr. i regjistrimit

Nr. i shasisë

Nr. i motorrit

Nr. i inventarit (mallit)

Kodi i ngjyrës

Kodi i pastrimit

Data e levrimit

Për sigurinë tuaj Toyota në këtë broshurë nuk ka përfshirë detajet e pronarit (zotëruesit të automjetit). Kjo është bërë për të shmangur mundësinë e humbjes së tyre në rast së ju thyejnë me forcë makinën ose e vjedhin atë. Ne ju keshillojmë të mos i lini dokumentet brenda automjetit si p.sh. dokumentet e siguracionit.

Vula e autorizuar e distributorit të Toyotes

Toyota Tirana

Autostrada Tiranë - Durrës
km 18

Tel/Fax: 048 302425

E-mail: Toyota.Tirana@abissnet.al

Pas kontaktit të shitjeve

Vula e autorizuar e riparuesit të Toyotës

Sherbimi dhe garancia:

Permbajtja

Informacion mbi garancine e prodhuesit te Toyotes	4
1. Shijoni Toyoten tuaj - krijuar per njeriun	4
2. Mbulimi i garancise se Toyotes me nje veshtrim te shpejte	5
3. Garancia e Toyotes e etajuar	6
4. Parashikime te pergjithshme te garancise se Toyotes	8
5. Probleme qe nuk i mbulon garancia e Toyotes	10
Programi per Mirembajtjen dhe Sigurine e Toyotes	12
1. Toyota juaj ka nevojte per kujdes te rregullt mirembajtje.....	12
2. C'eshte programi per Mirembajtjen dhe Sigurine?.....	3
3. Programi per Mirembajtjen dhe Sigurine dhe mbulimi i garancise se Toyotes	14
4. Sherbimi per Mirembajtjen dhe Sigurine dhe riparuesi juaj i autorizuar per Toyoten.....	15
5. Pjeset Origjinale Toyota.....	16
6. Riparimi i perplasjeve.....	19
7. Keshilla per Mirembajtjen dhe Sigurine e Toyotes.....	20
8. Programi i sherbimit per Mirembajtjen dhe Sigurine.....	22
Toyota dhe mjedisi.....	29
Regjistrimi i instalimit te aksesoreve.....	30
Vertetim Cilesie	32

1 Informacion mbi garancinë e prodhuesit të Toyotës

Shijoni Toyotën tuaj – krijuar për njeriun

Prioriteti i Toyotës ka qenë gjithmonë klienti. Ne shpresojmë që Toyota juaj të jetë një pjesë e rendësishme në jetën tuaj, diçka në të cilën ju gjeni mbështetje çdo ditë. Ja pse ne i përkushtohemi krijimit të automjeteve të standarteve më të larta me qëllim që ato të kënaqin nevojat tuaja gjithmonë e më tepër.


Mbulimi i garancisë që ne ofrojmë është ajo çka fshihet pas këtyre produkteve të shkëlqyera. Këtë e kuptojmë kështu: ne i përkushtohemi Cilësisë, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë së Toyotës suaj për t'i ofruar klientit tonë mirëqenie. Prandaj ju themi që Toyota “është krijuar për njeriun”, në mirëbesim reciprok që Toyota juaj do të jetë gjithmonë e lehte dhe për t'u drejtuar.

Kjo broshurë përshkruan kushtet e mbulimit të garancisë së Toyotës, sikurse edhe përgjegjësitë e përgjithshme të pronarit (zotëruesit të saj) dhe rekomandimet e listuara për mirëmbajtjen e saj. Lutemi lexojeni me kujdes.

I gjithë informacioni i kësaj broshurë është më i fundit i publikuar dhe mund të ndryshohet edhe më vonë pa ndonjë njoftim paraprak.

2

Mbulimi i garancisë së Toyotës me një vështrim të shpejtë



* kushdo që të ndodhe më parë

3 Garancia e Toyota e detajuar

1. E përgjithshme

Garancia mbulon çdo defekt që është pasojë e prodhimit ose ndonjë gabimi montimi gjatë përdorimit normal të automjetit për një periudhë 3-vjecare ose 100,000 km, kushdoqë të ndodhë më parë, pa ndonjë kufizim kilometrazhi për vitin e parë.

Garancia mbulon koston e rimorkimit të automjetit pranë riparuesit me të afërt të autorizuar të Toyotës në rast të një prishje që e bën të palevizshëm automjetin tuaj, nëse ky dëmtim është si pasojë e një defekti të garantuar.

2. Sipërfaqja e ndryshkur dhe sipërfaqja e lyer

Sipërfaqja e ndryshkur dhe defektet e bojës që mund të shfaqen në trupin e paneleve të ljera për shkak të ndonjë materiali ose punë të bërë, mbulohen nga një garanci 3-vjecare, paxvarësisht nga kilometrazhi.

3. Vrimat nga brejtja

Pamvarësisht nga kilometrazhi, garancia të siguron një mbulim 12-vjeçar, në rast se bëhen vrima në karrocerinë e automjetit (domethënë vrima tej përtej në karrocerinë e automjetit nga brenda jashtë) për shkak të brejtjes si pasojë e dëmeve të materialit apo punës së bërë.

“Karroceri e automjetit” quhet çdo trup me fletë metalike origjinale të Toyotës ke përfshihen pjesë si kapaku i motorrit, dyert, kapaku i bagazhit dhe paneli i dyshemesë, por ketu perjashtohen pjeset e ngjitura karrocetrisë si ornamente, amortizatore dhe mentesha. Lutemi t’i referoheni gjithashtu dhe faqës 20 për keshillat lidhur me Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Toyotës.

4 Parashikime të përgjithshme të garancisë së Toyotës

Kush është garantuesi?

Toyota garanton që automjeti i saj është prodhuar sipas standarteve më të larta dhe para lëvrimit (shitjes) është bërë kontrolli tërësor. Distributori i autorizuar i Toyotës do t'ju tregojë kontrollin e tij përmes vulosjes së vërtetimit të cilesisë në faqen e kontrollit të kësaj broshurë.

Ku ka mbulim me garanci Toyota ime?

Kushtet e garancisë së Toyotës sikurse janë të shpjguara në këtë broshurë zbatohen në shtetet vijuese: Albania, Andora, Austri, Belgjikë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Qipro, Republikën Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Gjibraltari, Greqi, Hungari, Islandë, Irlandë, Itali, Letoni, Litenshtein, Lituani, Luksemburg, Maltë, Norvegji, Poloni, Portugali, Rumani, Serbi dhe Mali i Zi, Republikën Sllovaqe, Slloveni, Spanjë, Suedi, Zvicër, Maqedonisë, Hollandë dhe Mbreterinë e Bashkuar.

Nëse ju keni në plan të udhëtoni në shtete të tjera përveç shteteve të lartpërmendura, ne ju rekomandojmë që ju të kontaktoni me distributorët ose riparuesit lokale të Toyotës për më shumë informacion.

Kur fillon garancia?

Periodha e garancisë fillon që nga data e lëvrimit shitjes të automjetit tek blerësi.

A do të ketë detyrime për riparimet që do t'i bëhen Toyotës sipas garancisë?

Jo. Riparuesi i autorizuar për Toyotën tuaj do të kryejë të gjitha riparimet që mbulohen sipas këtyre garancive kundrejt asnjë detyrimi për pjesët apo punën e bërë. Pjesët e automjetit mund të riparohen ose mund të zëvendësohen, në varësi të vendimit të marrë nga Toyota.

Cilat janë kushtet e garancisë?

- Ju duhet të siguroheni që e keni mirëmbajtur automjetin tuaj sipas specifikimeve dhe udhëzimeve të prodhuesit, sikurse janë paraqitur në manualin e pronarit (zotëruesit). Nëse nuk i përmbaheni pikave që lidhen me mirëmbajtjen atëherë garancia lidhur me këtë pjesë bëhet e pavlefshme.
- Ju duhet të mbani të gjithë regjistrimet e nevojshme për të vertetuar që një mirëmbajtje e tillë është bërë.
- Në rast defektesh që kërkojnë punë të lidhura me garancinë, ju jeni të detyruar ta çoni automjetin tuaj të riparuesi i autorizuar i Toyotës sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo për arsye të shmangies së zmadhimit të defektit dhe një riparimi më të madh të mundshëm nga sa do ishte e nevojshme që në fillim.

A mbulohen gomat?

Gomat mbulohen nga një garanci tjetër e siguruar nga prodhuesi i gomave. Për më shumë detaje konsultohuni me distributorin apo riparuesin e autorizuar të Toyotës.

Ç'ndodh nëse unë e shes Toyotën time?

Garancia e Toyotës i kalon automatikisht pronareve të rinj kundrejt asnjë kostoje.

A ndikohen të drejtat e mia ligjore nga garancia?

Jo. Të drejtat tuaja ligjore sipas legjislacionit në fuqi që drejton shitjen e mallrave konsumatore nuk ndikohen nga garancia.

5 Probleme që nuk mbulohen nga garancia e Toyotës

Ne ju pajisim me një paketë të gjerë garancie që reflekton cilesinë e Toyotës. Garancia e Toyotës hartohet për të mbuluar çdo defekt që lind si pasojë e prodhimit ose montimit.

Prandaj problemet e mëposhtme nuk mbulohen nga garancia:

Gërvishtja dhe konsumimi normal

Zhurma normale, dridhja, gërvishtja dhe konsumimi, dhe prishje të tilla si çngjyrimi, zbehja e ngjyrës apo deformimi.

Shpenzimet e mirëmbajtjes

Shërbimet normale të mirëmbajtjes të tilla si rregullimet e motorrit, zëvendësimi i lëngjeve dhe filtrave, lubrifikimi, pastrimi dhe llustrimi, zëvendësimi i fenereve dhe siguresave, dhe zëvendësimi i fshirëseve të xhamave, pedaleve të frenave dhe friksionit. Nëse kërkohet që këto shërbime të përfshihen në garancinë e riparimit, atëherë ato mbulohen nga garancia.

Automjetet me odometër (kilometrazhmatës) të ndryshuar

Dëmet në automjetet në të cilët odometri iu është ndryshuar kështu që kilometrazhi nuk mund të përcaktohet menjëherë.

Automjete të rikuperuara ose plotësisht të humbura

Çdo automjet që është cilësuar "i rikuperuar" ose me një titull të ngjashëm, ose është deklaruar si "i humbur plotësisht" ose ekuivalentja nga një institucion financiar ose sigurues.

Dëmtime të rastësishme

Dëmtime të rastësishme ose konsekuente të shoqeruara me dëmtim të automjetit.

Këto përfshijnë, por nuk janë të kufizuara kundrejt, mospërshtatjes, kostos së transportit, telefonatave dhe strehimit, humbjes së pasurisë personale apo tregtare dhe humbjes së pagesës apo të ardhurave.

Dëme që janë pasojë direkte apo indirekte e ndonjë prej elementeve të jashtëm, si më poshtë vijojnë:

- zjarri, aksidentet apo vjedhjet
- abuzimi apo neglizhenca
- shpërdorimi, për shembull garat apo mbingarkesat
- riparimet e bëra nga një riparues i paautorizuar i Toyotës
- instalime pjesësh jo Origjinale të markës Toyota
- ndërrimi apo fallsifikimi, përfshirë këtu instalime pjesësh jo Origjinale të markës Toyota
- mungesa e mirëmbajtjes së duhur, përfshirë këtu përdorimin e lëngjeve të tjera jo si ato të specifikuara në manualin e pronarit.

Programi për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Toyot5s

1 Toyota juaj ka nevojë për kujdes të rregullt mirëmbajtjeje

Një Toyota e shëndetshme = një Toyota e lumtur

Kjo është e vërtetë: Toyota nuk është ndryshe nga pronari i saj në këtë aspekt. Ju e dini sa i rëndësishëm është shëndeti për ju: sa më të shëndetshëm të jeni, aq më shumë jepni në jetë dhe aq më shumë merrni prej saj. Në një mënyrë apo tjetër ju vazhdimisht e kontrolloni shëndetin tuaj: për shembull, ju bëni ushtrime fizike që të jeni në formë, apo vizitoheni të doktori nëse jeni të sëmurë.

Ka tre arsye për t'u siguruar që ju po kujdeseni rregullisht për Toyotën tuaj:

1. Është thelbësore nëse ju dëshironi të keni shërbimin maksimal, siguri dhe besueshmëri nga Toyota juaj.
2. Për tu siguruar që garancia juaj është në fuqi për problemet lidhur me mirëmbajtjen (shih pjesën 3).
3. Kjo mund të rrisë vlerën e rishitjes së Toyotës tuaj

Mbajeni automjetin tuaj të shëndetshëm!

Ju duhet ta mirëmbani automjetin tuaj dhe të kujdeseni për të ashtu siç bëni me shëndetin tuaj. Duke patur këtë gjë parasysh, Toyota ka krijuar një program për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Toyotës tuaj.

2 Çështë programi për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë?

Programi për Mirembajtjen dhe Sigurinë përfshin dy elemente kryesore:

1. Ne ju rekomandojmë një sistem të programuar për shërbimet e Mirëmbajtjes dhe të Sigurisë për Toyotën tuaj. Ato janë ashtu si kontrollet mjekësore fizike që ju mund të keni bërë te doktori. Sistemi përfshin një shërbim të plotë Mirëmbajtje dhe Sigurie, të cilat ne ju këshillojmë t'i zbatoni çdo 30,000 km ose çdo dy vjet.
Përveç kësaj, ju rekomandojmë që në mes të çdo shërbimi të plotë të bëni një ndryshim të vajit dhe filtrit të vajit (me fjalë të tjera, pas 15,000 km ose një viti, pas 45,000 km ose tre vjetësh, e kështu me radhë).
Ne angazhohemi për të ruajtur Toyotën tuaj, dhe kjo është arsyeja që riparuesi i autorizuar i Toyotës do të kryejë falas shumë kontrolle të tjera Mirëmbajtjeje dhe Sigurie sikurse edhe ndërrimin e vajit dhe te filtrit. Për më shumë informacion shih pjesën 8 të programit të mirëmbajtjes.
2. Ne ju sigurojmë këshilla Mirëmbajtjeje dhe Sigurie për Toyotën tuaj. Këto udhëzime të detajuara për detyra të thjeshta mirëmbajtjeje ndihmojnë për të drejtuar pa problem makinën tuaj. Të gjitha këto janë tamam si aktivitetet ditore që ne kryejmë për tu kujdesur për shëndetin tonë si p.sh. larja e dhëmbëve dhe ushtrimet gjimnastikore. Për udhëzimet tona shih pjesën 7.

3 Programi për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë dhe mbulimi i garancisë së Toyotës

Mirëmbajtja e automjetit tuaj sipas rekomandimeve të këtij dokumenti kërkohet për tu siguruar që mbulimi i garancisë të jetë i vlefshëm për problemet e lidhura me mirëmbajtjen. Ju duhet të mbani regjistrime të detajuara të shërbimeve të Programit për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e automjetit tuaj, përfshirë këtu datat e shërbimit dhe instalimet e pjesëve. Nëse e shisni automjetin, duhet të siguroheni që të gjitha regjistrimet e shërbimeve të mirëmbajtjes ia keni dhënë pronarit të ri.

Toyota nuk do të mohojë një riparim garancie të mëvonshëm vetëm se ju përdoret një sigurues shërbimesh dhe jo një riparues të autorizuar të Toyotës.

Megjithatë, garancia nuk mbulon dëmtimet që janë pasojë e mungesës së shërbimit të duhur sipas specifikimeve dhe udhëzimeve të prodhuesit, ose përdorimit të lëngjeve të tjera jo të atyre të paraqitura në manualin e pronarit.

Riparuesi juaj i autorizuar i Toyotës mund t'ju rekomandojë intervale shërbimi më të shpeshta për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë përveç atyre të listuara në këtë broshurë.

Nëse ju ndodh kjo, mund të pyesni lirisht mbi arësyet e një rekomandimi të tillë.

4 Shërbimi për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë dhe riparuesi juaj i autorizuar për Toyotën

Me qëllim që ta mbani automjetin tuaj në kushtet më të mira të mundshme, Toyota ju rekomandon që të gjitha riparimet dhe shërbimet të bëhen nga riparues të autorizuar të Toyotës ose nga profesionistë të kualifikuar. Për riparime dhe shërbime të mbuluara nga garancia duhet t'i drejtoheni një riparuesi të autorizuar të Toyotës, i cili do të përdorë pjesë origjinale të markës Toyota për të riparuar problemet e mundshme.

Gjithashtu ju mund të keni avantazh nëse riparoni automjetin tuaj tek një riparues i autorizuar i Toyotës edhe për probleme që nuk mbulohen nga garancia, pasi ata janë të specializuar duke punuar me automjetet Toyota, dhe janë anëtare të rrjetit të Toyotës të cilet mund t'ju ndihmojnë juve me mjeshtëri nëse keni probleme me automjetin tuaj.

5 Pjesët Origjinale Toyota

Ne ju rekomandojmë duke ju theksuar që për riparimë dhe shërbime të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë së automjetit tuaj të përdorni pjesë origjinale të markës Toyota. Ato janë bërë sipas standarteve më të larta të cilësisë dhe performancës, dhe janë projektuar për t'ju përshtatur specifikimeve ekzakte të automjetit tuaj. E njëjta gjë vlen edhe për vajin dhe lëngjet e tjera. Për të shmangur rrezikun për dëmtime serioze të motorrit të automjetit, ju duhet të dini që për këtë përdoren produkte kimike, në përputhje me specifikimet e Toyotës.

Pjesët Origjinale Toyota: kurimi i duhur

Mendoni kështu: nëse do ju dhimbte shpina ju do të shkonit tek doktori apo spitali më i mirë për tu kuruar, sepse ju e dini që në këtë mënyrë do të merrni kurën e duhur dhe ilaçet e duhura në mënyrën e duhur.

Ju jeni të sigurtë që do të merrni shërbimin optimal për automjetin tuaj kur shkoni tek një shitës apo riparues i autorizuar i Toyotës, të cilët përdorin Pjesë Origjinale Toyota, dhe kanë inventar pajisjesh dhe pjesësh të ndryshme që mund t'ju nevojiten për problemin e mundshëm që mund të këtë automjeti juaj. Ata janë të lidhur në mënyrë elektronike me Qendrat e Shpërndarjes së Pjesëve Toyota, domethënë që ata kanë akses të shpejtë për të gjitha pjesët.

Veçanërisht, lutemi të shënoni gamën e produkteve origjinale që vijojnë të krijuara posaçërisht për mirëmbajtjen e aparencës së Toyotës tuaj.

Pjesët Origjinale Toyota: Mirëmbajtja

Për lubrifikimin optimal të motorrit tuaj, duhet gama e produkteve të **Motorrit me Vaj Origjinal të Toyotës**, të testuar dhe aprovuar posaçërisht për të gjithë motorrat Toyota. Këtu përfshihen të gjithë vajrat e njohur të motorrave dhe ingranazheve, të cilët ia kalojnë të gjitha etapave të njohura ndërkombëtare, të licensuara nga API dhe të njohura sipas standardeve ACEA. Rekomandohet gjithashtu që ju të perdorni lubrifikues origjinal Toyota për mirëmbajtjen optimale të motorrit tuaj dhe sistemeve të transmissioinit.

Për të maksimizuar performancën e motorrit thelbësor është sistemi i ftohjes. Ftohësi Origjinal **Toyota me një Super Jetëgjatesi** është antifrizë me bazë etilen-glikoli i cilësisë së lartë me veti të shkëlqyera mbrojtjeje nga gërryerja. Ai është formuluar posaçërisht për përdorim në automjetet Toyota dhe rekomandohet fuqishëm për të mbrojtur sistemin ftohës.

Bateria është zemra e sistemit elektrik të automjetit. Nëse për çfarëdo arsye ajo duhet zëvendësuar, një gamë e përmbledhur **Baterish Toyota Origjinale** është i përshtatshëm. Ato paraqesin teknologjine më të fundit, përfshirë këtu një hidrometer që lejon kontrollin e gjendjes së ngarkesës lehtësisht me sy, dhe nuk është nevoja për rimbushjen me ujë.

Për tu siguruar që ju gjithmonë gëzoni një shikim perfekt kur ngisni makinën, ju duhet një gamë e përmbledhur **Llampash Toyota Origjinale**, përfshirë këtu një kuti të zakonshme të ndihmës së shpejtë e cila përmban një seleksion llampash të rëndësishme zëvendësimi plus siguresa.

Nëse xhami i përparme është i piset dhe i njollosur atëherë ekziston rreziku i sigurisë. Për të patur një pastrim perfekt, ne ju rekomandojmë **Detergjente Toyota Origjinale për Larjen e Xhamit të Përparme**, i cili është një produkt me bazë etanoli formuluar posaçërisht për përdorim në të gjithë automjetet Toyota.

Pjesët Origjinale Toyota: aparencia

Për mirëmbajtjen e automjetit tuaj, lutemi të kontrolloni gamën Origjinale të Toyotës për Kujdesin e Automjetit, ku bëjnë pjesë produktet që vijojnë: Shampo, Lustrues, Pastrues i Jashtëm, Pastrues Tapicerie, Pastrues Lekurë, Pastrues Xhamash, Pastrues Rrotash, Sprai për Kroskotin dhe Akullshkrires. Këto produkte pastrimi janë ideale për mirëmbajtjen e aparencës së Toyotës tuaj.

Gërvishtje të vogla dhe çiflosje gurësh janë të bezdisshme. Koleksioni **Original Toyota i Bojës për Lustrim** është krijuar për të plotësuar kërkesën në rritje për gjetjen e një produkti cilësor për njolla të tilla në shtresën e bojës së automjetit. Ai është koleksioni ideal për pronarët e një makinë Toyota pasi boja prodhohet nga prodhuesi original i bojës dhe kjo garanton një përputhje dhe lluster bojë perfektë. Kjo ofrohet në dy forma, me laps dhe aerazol.

Për më shumë informacion mbi këto koleksione, lutemi të kontaktoni shitësin apo riparuesin e autorizuar tuajin lokal të Toyotës.

Lutemi të shënoni që pjesët Origjinale Toyota mund të sigurohen gjithashtu edhe nga profesioniste të tjerë të kualifikuar. Përveç kësaj mund të përdoren edhe produkte të tjera ekuivalente të një cilësie të përshtatshme. Ne ju rekomandojmë që ju t'i kërkonit riparuesit lokal t'ju vërtetoje që pjesët e përdorura, të cilat nuk janë produkte origjinale të Toyotës, të jenë të një cilësie të barasvlefshme.

6 Riparimi i përplasjeve

Nëse makina juaj është përplasur, ju sigurisht doni t'i bëni riparimin e duhur. Ju do të kërkonte të ruani vlerën e Toyotës tuaj, performancën e saj dhe aparencën, dhe duke u mbështetur në garancinë 12-vjeçare për mbulimin e vrimave nga brejtja, ju dëshironi që automjeti juaj Toyota të kthehet në gjendjen e mëparareshme.

Ne ju garantojmë demaskim të plotë nga dyqanet e riparimit dhe shoqërite e sigurimit persa i perket pjesëve të përdorura për riparimin e vrimave nga brejtja. Disa prej tyre mund të sugjerojnë përdorimin e pjesëve të përdorura apo imitacione për të kursyer paratë. Këto pjesë nuk mbulohen nga garancia e Toyotës, sikurse dhe dëmet që janë rrjedhojë direkte apo indirekte nga instalimi i këtyre pjesëve.

Mbroni investimin tuaj: sigurohuni që Toyota juaj po merr kurimin e duhur pas aksidentit.

7 Lista e kujdesit për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Toyotës

Kuptohet, është më mirë të shmangësh një problem para se të shfaqet papritur dhe të merreni me të për ta zgjidhur. Kjo është si ajo shprehja e vjetër, "Parandalimi është më mirë se kurimi". Për ta patur Toyotën tuaj në gjendje optimale, zbatoni udhëzimet e thjeshta si më poshtë:

Parandalimi është më mirë se kurimi

Mirëmbajtja

- Motorri i Toyotës tuaj është zemra e tij: para se ta perdorni atë intensivisht bëni ngrohjen e duhur të tij. Pasi të filloni një motorr të ftohtë, shmangni ngrohjen e lartë kur të bëni kilometrat e parë. Kjo siguron ngrohjen më të mirë dhe një jetëgjatësi të motorrit.
- Ju besoj e dini efektin që mund të kenë në rendimentin e punës tuaj dhimbjet e shpinës apo të kyçeve. Kështu Toyota juaj ka nevojë për lubrifikim gjithashtu. Me qëllim që motorri i Toyotës të funksionojë normalisht, duhet të dini që konsumi i vajit ndryshon në varësi të kushteve të drejtimit të makinës. Ju rekomandojmë të kontrolloni nivelin e vajit rregullisht (veçanërisht kur të udhëtoni në distanca të largëta, apo kur koha të jetë e nxehtë).
- Për të ruajtur efikasitetin e kondicionerit, ndizeni atë për të paktën dy minuta në muaj.

Siguria

- Kontrolloni nëse fenerët, dritat anësore (sinjalet anësore), sinjalet treguese dhe sinjalet "stop" po punojnë siç duhet.
- Kontrolloni nëse lareset dhe fshireset e xhamit të përparme po punojnë siç duhet, dhe që ka lëng larës të mjaftueshëm.
- Kontrolloni gomat (përfshire këtu edhe gomen rezerve) nëse janë konsumuar, dëmtuar dhe ushtrojnë shtypjen e duhur. Kjo është e domosdoshme për qëndrueshmërinë, rehatinë, drejtimin e sigurt të makinës dhe konsumin e paket të karburantit.

Higjiena dhe të tjera

- Lajeni automjetin tuaj rregullisht. Përdorni ujë të ftohtë, të pastër dhe sapun larës të butë dhe thajeni automjetin në hije. Nëse e ngisni makinën në rrugë të kripura apo me pluhur, ose nëse e ngisni përgjate bregut të detit, lajeni sottocarcterin (pjesën e poshtme të shasisë) të pakten një herë në muaj. Është e rëndësishme që të mbani të pastra vrimat e kullimit në fund të dyerve dhe parvazeve të dritareve të automjetit.
- Jini syhapur. Duhet të fshini menjëherë balten, papastërtite, insektet, ziftin, glaset e zogjve etj nga sipërfaqja e lyer e makinës. Po të shihni çiflosje apo gërvishitje në sipërfaqen e lyer, lyejeni menjëherë duke përdorur materialin e rekomanduar. Nëse bëni ndhëtime të shpeshta në rrugë me zhavorr, instaloni parafanga prapa çdo rrotë të automjetit.

8 Programi i shërbimit për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë

1. Shërbimi i plotë i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë: çdo 30,000 km ose çdo 2 vjet*
2. Shërbimi i ndërmjetëm i vajit dhe filtrit, kontrolluar falas nga riparuesi juaj i autorizuar i Toyotës: çdo 15,000 km ose çdo 1 vit*. Kontrollat e Mirëmbajtjes dhe të Sigurisë të bëra nga riparuesi juaj i autorizuar i Toyotës do të mbulojnë sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit të makinës, ndriçimin dhe gomat

Për kushte normale drejtimi të makinës

Z = Zëvendësimi / K = Kontrolli / Sh = Shtërngimi

	I ndermjetem	I plote
● Mbarëvajtja		
Vaji i motorrit dhe filtri i vajit	Z	Z
Ftohësi i motorrit		K
Filtri i ajrit	K	K
Kandelat (lloji normal)		K
Vaji i diferencialit të pasme dhe të transmetimit (RAV4 4WD)		Z
Mbajteset e boshtit motorrik		K
Bulonat e boshtit motorrik*1		Sh
Tubat e shkarkimit të gazit dhe instalimet (motor dizel, naftë)	K	K
Tubat e sistemit të ngrohjes dhe ftohjes dhe bashkueset		K
Filtri i kondicionerit	Z*2	Z
Kapaku i serbatorit, shtresat e serbatorit, valvula e kontrollit të avullit dhe lidhjeve		K
Inspektimi i trupit (gerryerjet)		K

*1: për MR2 dhe RAV4 4WD

*2: Yaris Verso

* cilado të ndodhe e para

	I ndermjetem	I plote
● Siguria		
Pedalja e frenave dhe frenat e dorës		K
Guarnicioni i frenave dhe bucela e frenave (përfshirë guarnicionin e frenave të dorës kur është i zbatueshem)		K
Pedalet e frenave dhe disqet	K	K
Lëngu i friksionit (përveç Yaris, Corolla, Corolla Verso me MMT dhe Aygo)		K
Lëngu vijues i sistemit M/T (MR2)		K
Lëngu i frenave		Z
Tubat e frenave		K
Lëngu i fuqisë së drejtimit të timonit		K
Suspensionin I parme dhe i pasme		K
Timoni me rakordimet		K
Rrotat, dritat, fshireset e xhamave, uji lares	K	K
Fuqia e drejtimit të timonit, xhuntut, mbulesat e pluhurit		K

● **Zëvendësime shtese**

Ripi fazor i motorrit (vetëm për motorrat 2.0 D4D)	Për çdo 105,000 km
Filtri i Ajrit	Për çdo 4 vjet / 60,000 km
Filtri i karburantit motorrat D4D benzina Aygo	Për çdo 6 vjet / 60,000 km Për çdo 180,000 km
Kandelat te llojit normal te llojit Platin apo Iridium	Për çdo 4 vjet / 60,000 km Për çdo 90,000 km
Ftohesi i motorrit	Në fillim pas 150,000 km Më pas, çdo 90,000 km
Pompa me vakum për frenen ndihmese (Yaris D4D)	Për çdo 195,000 km
Filtri i kutise së qymyrit (Aygo)	Për çdo 90,000 km

● **Kontrolle shtese**

Rrip transmissioni ndihmës (Alternator, A/C, PS)	Viti i gjashtë / 105,000 km Më pas, çdo vit / 15,000 km
Zhblokim i valvulës (kontroll i dëgjueshëm) motorra me benzinë motorra 1.4 dhe 2.0 D4D	Për çdo 6 vjet / 90,000 km Për çdo 4 vjet / 45,000 km
Pompa me vakum për frenën ndihmëse*5	Për çdo 195,000 km
Kutia e grupit të ingranazheve dhe vaji i diferencialit të parë*3	Për çdo 4 vjet / 60,000 km
Transmissioni automatik dhe lëngu i diferencialit të parë	Për çdo 3 vjet / 45,000 km
Kutia e qymyrit	Për çdo 2 vjet / 45,000 km Çdo 90,000 km*4
Kutia e qymyrit për Aygo	Çdo 90,000 km
Tym dizeli (naftë)	Për çdo 4 vjet / 45,000 km
Pedali i friksionit, balestra e kthimit dhe amortizatori (Aygo)	Çdo 30,000 km

*3: për MR2, vajin e diferencialit të pasme

*4: vetëm për Finlandën, Norvegjinë dhe Suedinë

*5: për Yaris Verso D4D, Corolla D4D, Corolla Verso D4D, Avensis D4D

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 15,000 km / 1 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 30,000 km / 2 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 45,000 km / 3 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 60,000 km / 4 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 75,000 km / 5 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 90,000 km / 6 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 105,000 km / 7 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 120,000 km / 8 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 135,000 km / 9 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 150,000 km / 10 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 165,000 km / 11 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 180,000 km / 12 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 195,000 km / 13 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 210,000 km / 14 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 225,000 km / 15 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 240,000 km / 16 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 255,000 km / 17 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 270,000 km / 18 vit*

SHERBIMI DHE GARANCIA

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 285,000 km / 19 vit*

Shërbim i përfunduar
Kilometrazhi:
Data:
i ndërmjetëm 300,000 km / 20 vit*

Toyota dhe mjedisi

Tek Toyota, ne shohim misionin tonë për të siguruar produkte të pastra dhe të sigurta përkrah punës së lodhshme për një shoqëri të zhvilluar dhe mjedisi të këndshëm për të jetuar.

Automjetet gjatë prodhimit të tyre harxhojnë lënde të parë dhe energji, gjatë fazës së përdorimit shkarkojnë avuj dhe gazra, dhe në mbarim të jetës së tyre asgjësohen. Zvogëlimi i ndikimit të mjedisit gjatë gjithë ciklit të jetës së automjetit është sfida kyçe për Toyotën, ndaj kjo është dhe arsyeja pse ne kemi krijuar Sistemin e Vlerësimit Ekologjik të Automjetit (ECO-VAS), që mat ndikimin e mjedisit në çdo fazë.

Për fazën finale të asgjësimit të automjetit, dhe në vijimesi me objektivat e Udhëzimit të Bashkimit Europian mbi Fundinë Jetëse Automjetit 2000/53/KE, Toyota ka bërë mjaft përpjekje për të zvogëluar apo ndaluar lëndet shqetësuese, për të minimizuar plehrat që mbushin tokën, për të ripërdorur ose ricikluar pjesët dhe përbërësit. Për më shumë informacion lidhur me këtë Udhëzim të Bashkimit Europian dhe Fundinë Jetëse Automjetit të aprovuar për Toyotën, mund t'i drejtoheni sitit në internet www.toyota-europe.com ose www.NMSCWEB.ADDRESS ose telefononi ++NMSCdedicatedphone.

Ju gjithashtu mund të ndihmoni mjedisin duke e përdorur Toyotën tuaj në mënyrën e duhur. Këshillat më poshtë do ju ndihmojnë që të ulni konsumin e karburantit dhe ndërprerjen e shkarkimeve të gazrave dhe avujve në minimum:

- sigurohuni që presionet i keni në rregull
- mos i jepni supërxihiro motorrit kur makina është në prehje
- shmangni nxitimin e lartë dhe të shpeshtë
- ndërroni marshet në kohë
- mos mbani ngarkesa të panevojshme
- hiqni mbajtësit e skive dhe të bagazhit kur nuk janë në përdorim

Më së fundi, nëse një riparues i autorizuar i Toyotës ju bën kontrollin për Mbarëvajtjen dhe Sigurinë e automjetit tuaj, jini të sigurtë se pjesët ose kimikatet e zëvendësuarat asgjësohen apo riciklohen në një mënyrë të dobishme për mjedisin dhe duke u kujdesur për të.

Regjistrimi i instalimit të aksesoreve

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Emri i aksesorit	_____
Numri i pjesës	_____
Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i Instaluesit / kodi	_____

Regjistrimi i zëvendësimit të odometrit (kilometrazhmatësit)

Data e Instalimit	_____
Kilometrazhi i Instalimit	_____
Emri i riparuesit te	_____
Autorizuar te Toyotes / kodi	_____

Vërtetim cilësie

Toyota shquhet për shkallën e kontrollit rigoroz të cilësisë që ajo aplikon në çdo etapë të prodhimit. Ky rrjet kontrolli bën të mundur sigurimin që të gjitha përgatitjet (pjesët) janë perfunduar siç duhet dhe në momentin e levrimit të automjetit ai është në gjendjen më të mirë.

Nëpërmjet këtij vërtetimi nënshkruesi më poshtë ju siguron se automjeti është prodhuar në përputhje me kriteret e rekomanduara të Toyotës.

Drejtori i Departamentit
